



KURS I EDUKATËS QYTETARE *Për të qenë shtetas italianë*



Përmbajtja

Moduli 1 – Histori e shkurtër e Italisë

Moduli 2 – Kushtetuta italiane

Moduli 3 – Të dhënat demografike

Moduli 4 – Rregulli institucional qendror

Moduli 5 – Rregulli territorial administrativ

Moduli 6 – Familja

Moduli 7 – Puna

Moduli 8 – Sistemi i edukimit, trajnimit dhe arsimimit për të rriturit

Moduli 9 – Sistemi shëndetësor

Moduli 10 – Dokumente të vlefshme në territorin italian

Moduli 11 – Banesa. Pronat me qira.

Moduli 12 – Sistemi i sigurimit shoqëror

Moduli 13 – Sistemi tatimor

Moduli 14 – Marrëveshja e Integritimit dhe Kartës së Qëndrimit

Moduli 15 – Shtetësia



Formular 1
HISTORI E SHKURTËR E ITALISË

Histori e shkurtër e Italisë


Në antikitet Roma ishte kryeqyteti i perandorisë romake që shtrihej nga Anglia në Egjipt, nga Portugalia në Mesopotami (Iraku i sotëm)



Gjuha e perandorisë romake ishte latinishtja. Nga latinishtja kanë lindur gjuhët moderne neolatine: italishtja, spanjishtja, frëngjishtja, portugalishtja e rumanishtja

. “Shekulli i artë” i gjuhës italiane është rreth viteve 1300 kur bëhen të njohur tre shkrimtarë: Dante, Petrarka e Bokaçio.

Dante Aligieri (Alighieri), autor i Komedisë Hyjnore (Divina Comedia) konsiderohet si themeluesi i gjuhës italiane.




Deri më 1861 Italia është e ndarë në shumë shtete, disa të udhëhequr nga Shtete të huaja: (Austria, Spanja, Franca)



1861: lind Shteti italian, por Roma është akoma kryeqyteti i Papatit i udhëhequr nga Papa.



 **1870:** Roma pranohet të bëhet pjesë e Shtetit italian e bëhet kryeqyteti i ri i shtetit.

 **1861 – 1922:** Italia është një monarki parlamentare. Mbreti i parë është Viktor Emanueli II (Vittorio Emanuele II) i familjes Savoia.



 **1922 – 1943:** Italia është nën një diktaturë, fashizmin.

Gjatë regjimit italianët nuk kanë lirinë e fjalës, të shtypit dhe të shoqatave.





Pas Luftës së Dytë Botërore, Italia bëhet një vend demokratik.

Futet e drejta e votimit për të gjithë: kanë të drejtën e votës të gjithë, burrat dhe gratë.



1946: Në vitin 1946 populli italian përmes një referendum vendos fundin e monarkisë dhe lindjen e **Republikës italiane.**



PROF. VINCENZO CARULLO
DIRETTORE GENERALE DI EDITORE
LA COSTITUZIONE
DELLA
REPUBBLICA ITALIANA
ILLUSTRATA

Moduli 2

KUSHTETURA ITALIANE

EDITORE

Kushtetuta italiane

Është miratuar në vitin 1947 dhe është ligji themelor i shtetit.

Të gjithë ligjet italiane duhet të përputhen me parimet dhe vlerat e Kushtetutës.



Kushtetuta përbëhet nga 139 nene dhe është e ndarë në dy pjesë:

- Pjesa e parë përshkruan parimet themelore të Shtetit edhe të drejtat dhe detyrimet e nënshtetasve.
- Pjesa e dytë përshkruan organizimin e Republikës, pra strukturën e shtetit dhe figurat institucionale të tij.

Figurat institucionale: Dhoma dhe Senati, Presidenti i Republikës, Qeveria dhe Gjykata.



Neni. Italia është një Republikë demokratike
1 e themeluar mbi punën.

Neni. Republika njeh dhe garanton të drejtat
2 e padhunueshme të njeriut, si individ
ashtu edhe në grupe shoqërore (...)

Neni. Të gjithë shtetasit janë të barabartë
3 para ligjit, pa dallim gjinie, race, gjuhe,
feje, mendimi politik, dhe gjendje
personale apo shoqërore.

Neni. Të gjitha besimet fetare kanë të njëjtën
8 liri para ligjit.

Neni. I huaji, të cilit i është mohuar në
10 vendin e tij ushtrimi i përhershëm i
lirive demokratike të garantuara nga
Kushtetuta italiane, ka **të drejtën e**
strehimit (azilit) në territorin e
Republikës sipas kushteve të
përcaktuara me ligj.

Neni. Italia kundërshton luftën si vegël
11 lënduese e lirisë të popujve të tjerë dhe
si mjet zgjidhjeje të mosmarrëveshjeve
ndërkombëtare.

Neni. Liria personale është e paprekshme.
13 Nuk lejohet asnjë formë e kufizimit të
lirisë personale, përveçse me akt të
motivuar nga Autoriteti gjyqësor dhe
vetëm në rastet e parashikuara nga
ligji.

Neni. Liria dhe fshehtësia e korrespondencës
15 dhe të gjitha format e tjera të komunikimit janë të paprekshme.

Neni. Shtetasit kanë të drejtë të tubohen
17 paqësisht dhe pa armë.

**Neni.
21** Të gjithë kanë të drejtë të shprehin lirisht mendimet e tyre me çdo mjet komunikimi. Shtypi nuk mund tu nënshtrohet autorizimeve apo censurave.

**Neni.
38** Çdo shtetas i paaftë për punë dhe pa mjete jetese, ka të drejtën e mbajtjes dhe të asistencës sociale.

Neni. Votues janë të gjithë shtetasit, burra
48 e gra, të cilët kanë moshë madhore.

Neni. Shtetasit e njërës apo tjetrës gjini
51 mund të punësohen në zyrat publike
dhe postet zgjedhore.

Të drejtat qytetare

- Liria personale, e lëvizjes, e shoqatës, e mbledhjes, e ndërgjegjes dhe e besimit fetar.
- Barazia para ligjit;
- E drejta e presumimit të pafajësisë;
- E drejta që të mos i hiqet pasuria pa të drejtë (arbitrarisht);
- E drejta e nënshtetësisë



Të drejtat politike

Janë të lidhura me pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisjen e shtetit.

Mënyrat e pjesëmarrjes janë:

- *të drejtpërdrejta: përmes institucioneve të tilla si referendumi, peticioni, etj.*


- *të tërthorta: nëpërmjet zgjedhjes së përfaqësuesve.*



Të drejtat sociale

- Të drejtat për mbrojtje sociale kundër sëmundjes, pleqërisë, papunësisë, etj.
- E drejta e shëndetit;
- E drejta e arsimimit;
- E drejta e punës, ecc.





Moduli 3

TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

Të dhënat demografike


Shuma e popullsisë në janar 2011: **60.600.000**
nga të cilët emigrantë banues: 5.000.000

Gjithsej Meshkuj: 48,5%
Gjithsej femra: 51,5%

Të dhëna mbi gjendjen civile
Të martuar : 29.890.000
Të divorcuar : 1.185.000
Të vejë / ja : 4.550.000



Bashkësitë e huaja kryesore në Itali





Moduli 4


RREGULLI INSTITUCIONAL

QËNDROR



Demokracia

Italia është një Republikë demokratike.
Karakteristikat kryesore të kësaj forme qeverie janë:



- sovraniteti i popullit
- ndjekja e parimeve themelore të lirisë dhe barazisë



Pushtetet e Shtetit

Pushtetet e shtetit janë tre:

**PUSHTETI
LEGJISLATIV**

**PUSHTETI
EKSEKUTIV**

**PUSHTETI
GJYQËSOR**

Pushtetet e Shtetit janë të ndara nga njëra-tjetra dhe veprojnë në mënyrë të pavarur brenda kufijve të udhëhequra nga Kushtetuta.

PUSHTETI LEGJISLATIV

- ka fuqinë për të bërë ligjet
- ushtrohet nga Kuvendi

Kuvendi promovon dhe miraton ligjet e Shtetit.

Ai përbëhet nga dy organe:

- *Dhoma e Deputetëve*
- *Senati*

Zgjedhjet bëhen çdo 5 vjet.



PUSHTETI EKSEKUTIV

- është pushteti që zbaton ligjet
- i është besuar Qeverisë

Qeveria e vendit i vë në praktikë vendimet e Kuvendit.

Ajo përbëhet nga:

- Kryeministri (ose Kreu i Qeverisë) që emëron dhe bashkërendit Ministrat.
- *Ministrat, secili nga ata i caktuar në një fushë të punëve shtetërore.*

Shembuj: Ministri i Punës, Min. i Ministrisë Brendshme, Min. i Shëndetësisë, Min. i Punëve të Jashtme dhe kështu me radhë.

PUSHTETI GJYQËSOR

- është fuqia që bën të respektohen ligjet, të ndëshkohen fajtorët e krimeve, të vendosë të drejtat dhe gabimet në mes njerëzve
- i është besuar Organeve të Drejtësisë

Gjyqtarët monitorojnë zbatimin e ligjeve dhe zhvillojnë proceset gjyqësore.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (CSM) është organi i vetëqeverisjes të Gjykatës dhe garanton pavarësinë nga dy pushtetet e tjera të Shtetit.



Përveç Kuvendit, Qeverisë dhe Gjykatës së Lartë, ka organe të tjera institucionale shumë të rëndësishme:

Presidenti i Republikës


- është garant i Kushtetutës
- përfaqëson Shtetin në marrëdhëniet e tij me Shtetet e tjera
- zgjidhet çdo 7 vite



Presidenti i tanishëm i Republikës është Sergio Mattarella.

Gjyqi Kushtetues

- vendos, me kërkesë, nëse një ligj respekton Kushtetutën
- nëse ligji nuk e respekton Kushtetutën, Gjyqi Kushtetues e shfuqizon ligjin



Administrata

Bëjnë pjesë në Administratë:

- Zyrat e shpërndara në të gjithë territorin e Republikës që kujdesen për nevojat e nënshtetasve
- *Ministritë*
- *Forcat e Policisë*, të vëna në krye të mbrojtjes të brendshme



Forcat e Armatosura

Forca të vëna në krye të mbrojtjes së jashtme.

Bëjnë pjesë në Forcat e Armatosura:

- *Ushtria Italiane*
- *Flota detare Ushtarake*
- *Aviacioni Ushtarak*
- *Arma e Karabinierëve*



Organet e sigurimit publik

Persona e organe që merren me sigurimin e nënshtetasve

Në çdo provincë gjendet:

- një *prefekt* →

Përfaqësues i Qeverisë mbi territorin përkatës. Urdhërat e tij zbatohen menjëherë.

- një *kuestor* →

Bashkërendon të gjitha FORCAT E POLICISË të Provincës.

Numra të dobishëm:
112 Karabinierët **113**
Policia



Moduli 5
RREGULLI ADMINISTRATIV
TERRITORIAL



Organizimi mbi territorin

KRAHINË

PROVINCË

BASHKI



Krahina

Krahinat janë 20.

Merren me: shëndetësinë, rrjetin e transportit, ujërat, energjinë, punën, formimin profesional. Mund të bejnë ligje. Zgjedhje çdo 5 vite.

Në çdo Krahinë gjendet një Drejtor i përgjithshëm e një Këshill Krahinor.



Regione Puglia



Regione Lombardia




Provinca

Provincat janë 110 por është e parashikuar të bëhen 51. Merren me: arsimimin dytësor të shkallë së 2^o, ambientin, mbeturinat, rrjetin rrugor, mbrojtjen civile, kursimin energjitik.

Zgjedhje çdo 5 vite.

Në çdo Provincë ka një President e një Këshill Provincial.



Bashkia

Bashkitë janë 8.092.

Merren me: shërbimet shoqërore, çerdhet, kopshtet për fëmijë, ndërtimet dhe të drejtën e studimit në shkollat parësore e dytësore, gjendjen civile, varrezat, mbikqyerjen e qytetit, planin e ndërtimit, qarkullimin rrugor, liçencat e biznesit, kulturën, shërbimet zgjedhore.

Zgjedhje çdo 5 vite.

Në çdo Bashki ka një Kryetar bashkie dhe një Këshill Bashkiak.

Të gjithë organet (Drejtori i përgjithshëm i Krahinës, Presidenti i Provincës, Kryetari i Bashkisë dhe Këshillat Krahinor, Provincial dhe atij Bashkiak) janë të zgjedhur nga populli.



Qeveria emëron një **Prefekt** për çdo provincë përgjegjës i sigurisë, urdhërat e të cilit zbatohen menjëherë.

Harta e krahinave

Italia ka 20 krahina.

Çdo krahinë ka një qytet kryeqendër.

Shembuj: Kryeqendra e Krahinës Piemonte është Torino.

Çdo krahinë është e nëndarë në Provinca.

Shembuj: Krahina e Kampanias (Campania) është e nëndarë në 5 Provinca: Avellino, Benevento, Caserta, Napoli e Salerno.



Krahina Lacio

Banues janë: 5.775.000
prej të cilëve të huaj: 615.000

Lacio është krahina e tretë për numër të banorëve pas Lombardisë e Kampanias (Campania).



Lacio është administrativisht i ndëdarë në 5 provinca:


-  **Frosinone** (91 Bashki)
-  **Latina** (33 Bashki)

-  **Rieti** (73 Bashki)
-  **Roma** (121 Bashki)
-  **Viterbo** (60 Bashki)

Bashkësitë e huaja kryesore anëtarë të BE në Lacio



Bashkësitë e huaja kryesore jo antarë të BE në Lacio



Qyteti i Romës

Banuesit janë: 2.743.796
prej të cilëve të huaj:
294.000

Është bashkia me numrin më të lartë të të huajve i ndjekur nga Milano.

Është Kryeqyteti i Italisë. Aty kanë selinë Presidenti i Republikës, Qeveria dhe Kuvendi.

Është qendra e Shtetit të Vatikanit.




Bashkitë e qytetit të Romës

Zona e qytetit të Romës është e ndarë në 15 Bashki.

Çdo Bashki ka një *President* e një *Komision* (4-6 Këshilltarë).

Zgjedhjet bëhen çdo 5 vite së bashku me zgjedhjet e Këshillit bashkiak.



Bashkitë drejtojnë:

- shërbimet demografike
- shërbimet e ndihmës sociale
- shërbimet shkollore dhe edukuese
- aktivitete dhe shërbimet kulturore, sportive dhe dëfryese.
- shërbimet e mirëmbajtjes të qytetit, drejtimin e pasurisë kulturore, planin e qytetit
- iniciativat për zhvillimin ekonomik në sektorin artizanal e tregtar
- rolet e policisë së qytetit





Moduli 6
FAMILJA

Çfarë është një familje?

Kushtetuta Italiane përcakton që *familja është një shoqëri natyrore e bazuar mbi martesën.*


Gjithashtu një çift(i martuar) pa fëmijë llogaritet një familje.



Përveç çifteve të martuar në Itali ka shumë familje jo të martuara.

Këto lidhje quhen:

- *Çifte bashkëjetues*: nëse s'kanë fëmijë;
- *Familje bashkëjetuese* : nëse kanë fëmijë.



Të drejtat e bashkëshortëve

- Bashkëjetesa: besnikëria, ndihma ndaj njëritjetrit, etj.
- Shtëpia: e drejta e bashkëbanimit (një bashkëshort nuk mund të përzihet nga shtëpia)

Në rast **sëmundjeje**

Të drejtën e qëndrimit në spital, marrjen e vendimeve, të drejtën e njoftimit, ecc.

Në rast **vdekjeje**

Të drejtën mbi pensionit, mbi TFR(trajtimi i përfundimit të punës), qiranë, trashëgiminë etj

Në rast **ndarjeje**

Të drejtën e dëmshpërblimit dhe pagesës ekonomike (të vendosur nga gjykatësi).

Aktualisht të drejtat e bashkëshortëve nuk janë të vlefshme për çiftet e përpamartuar.

Fëmijët kanë të njëjtat të drejta.

Prindërit kanë të njëjtat detyrime kundrejt fëmijëve të tyre.

NË RAST NDARJEJE NDËRHYN GJYKATËSI QË
PËRCAKTON MIRËBESIMIN MBI FËMIJËN

Martesa

Me martesën burri e gruaja fitojnë **të njëjtat të drejta e detyrime.**

Pë shembull: Të dy duhet të ndihmojnë për nevojat e familjes me punën vetjake (profesionale ose shtëpiake), të edukojnë fëmijët, të jenë besnikë.

Të dy mund të kërkojnë ndarjen edhe divorcin.

Në Itali është e mundur të zgjidhet martesë:

- me ceremoni *fetare*;
- me ceremoni *civile*.

Është e mundur të zgjedhet ndarja e pasurisë ose bashkëpronësia.




Bashkëpronësia: të gjithë të ardhurat dhe pasuritë të fituara pas martesës janë automatikisht pronë e të dyve.

Ndarja e pasurisë: çdo bashkëshort është pronar i vetëm i pasurive të fituara gjatë martesës.

Të martohesh në Itali

Kush martohet në Itali edhe pse i huaj i nënshtrohet legjislacionit italian

- ⇒ Martesa **në mes dy shtetasve të huaj**: është e mundur nëse të paktën njëri nga ata është i pranishëm rregullisht në territorin italian.
- ⇒ Martesa **në mes një shtetasi të huaj dhe një shtetasi italian**: nuk është e nevojshme të kesh lejeqëndrimin por mjafton një dokument identifikimi i vlefshëm (es. pasaportë)
- ⇒ Në rast të **dy shtetasve të huaj që nuk kanë lejeqëndrim** ose vendbanim në Itali, martesa mund të celebrihet vetëm tek Ambasada ose Konsullata e Vendlit të tyre në territorin italian



Shtetasi i huaj ka të drejtën e një lëshimi **lejeqëndrimi** për arsye familjare, edhe pse para martesë ishte një shtetas klandestin ose i parregullt në territor.

Shtetësia italiane nuk merret automatikisht me martesën.

Për të pasur Shtetësinë:

- 1) Duhet të kalojnë të paktën 2 vite nga martesë.
- 2) Shtetasi i huaj duhet të ketë **qëndrim** në Itali të paktën që dy vite (një vit nëse nga martesë kanë lindur fëmijë).



Fëmijët: shtatzania

Të gjitha gratë emigrante gjatë **shtatzënisë** kanë të drejtën e vizitave mjeksore dhe analizave falas (ekografi, analiza gjaku, etj). Mund të shkohet në spital ose tek Konsultoret familjare publike.



Të gjitha gratë, të rregullta në territor ose klandestine, kanë të drejtën e pranimit e të shtrimit në spital për **lindje**, kanë të drejtën e kurimit gjatë e pas lindjes.

Lejeqëndrimi: Nuk është e nevojshme të keni një lejeqëndrim E NËSE JENI KLANDESTINE NUK DO TË DENONCOHENI.

Fëmijët: lindja

ËSHTË E DETYRUESHME të regjistrososh lindjen e fëmijës.

- në spital: brenda 3 ditëve nga lindja
- në Bashki: brenda 10 ditëve nga lindja
- nga njëri prej prindërve (nëse çifti është i martuar)
- nga dy prindërit (nëse çifti nuk është i martuar)

Lindja mund të deklarohet nga një mjek, një mami ose kush ka qenë i pranishëm gjatë lindjes.

Shkollat: çerdhja pranon fëmijët nga muaji i 4 i lindjes. Është e nevojshme të bëhet regjistrimi para lindjes. Çmimi ndryshon në vartësi të gjendjes ekonomike të familjare (ISEE).

Vaksinimi: është i detyrueshëm dhe është falas vaksinimi i fëmijës. Vaksina e parë bëhet në muajin e tretë.

Në Itali janë të detyrueshëm vaksinimet kundër **difteritit, tetanozit, poliomielitit, hepatitit viral B.**



Moduli 7
PUNA



Puna

Të gjithë shtetasit kanë të drejtë për punë,
në bazë të mundësive të tyre.

Për këtë qëllim, Republika garanton:

- shpërblim proporcional dhe të mjaftueshëm
- pushimin javor dhe pushimet vjetore
- barazinë midis punonjësve burra dhe gra



- Mbrojtja e lehonisë për punonjëset .
- ndihmë për personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe viktimat e aksidenteve në punë

«**Statuti i Punonjësve**» është ligji që nga viti 1970 përcakton të drejtat themelore të punonjësve. Të drejtat dhe detyrat e të punonjësve rregullohen **me Kontratat Kombëtare Kolektive të Punës**. Çdo kategori ka një Kontratë të veçantë. Kontratat - të cilat ripërtërihen periodikisht - janë nënshkruar nga shoqatat e biznesit dhe sindikatave.



Eksistojnë tre tipologji punësimi:

- nëpunësimi ose punësimi në vartësi
- bashkëpunimi i koordinuar dhe i vazhdueshëm
- vetëpunësimi



PUNA

Nëpunësimi ose punësimi në vartësi

LLOJI I KONTRATËS

- *Me periudhë të caktuar (zgjat një periudhë të përcaktuar)*
- *Me periudhë të pacaktuar (nuk është përcaktuar kohëzgjatje)*

KOHA E PUNËS

- Orar i plotë
- Orar i pjesshëm

Shembuj: : nëpunësit, arsimtarët, nëpunësit bankarë, infermierët, etj.



PUNA

Bashkëpunimi i koordinuar dhe i vazhdueshëm

LLOJI I
KONTRATËS

bashkëpunim mes punëdhënësit
dhe punëmarrësit mbi një
program pa një marrëdhënie të
qëndrueshme

KOHA E
PUNËS

Nuk ka një orar të caktuar
(kohëzgjatja është e lidhur
me realizimin e projektit)

Shembuj : punonjësit e call center-it

PUNA

VETËPUNËSIMI

LLOJI I
KONTRATËS

Punonjësi nuk ka një punëdhënës dhe angazhohet për klientët e tij

KOHA E
PUNËS

Orari është i caktuar nga punonjësi

Shembuj: artizanët, tregtarët, profesionistët, etj.

Tregtarët duhet të respektojnë oraret e hapjes e mbylljes së dyqaneve.

Sindakatat

Kushtetuta njeh **të drejtën për t'u mbledhur në sindikata të punonjësve** për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave ekonomike të tyre në formë kolektive.

Mjet kryesor i luftës sindikale është **greva**, apo abstenimi nga puna.



Sindakatat kryesore italiane janë:



CGIL

6.300.000

të regjistruar



CISL

4.500.000

të regjistruar



UIL

2.200.000

të regjistruar



UGL

1.100.000

të regjistruar

Organizatat sindakale pajisin me shërbime punonjësit e regjistruar si edhe të paregjistruar.

Shembuj: praktika për marrjen e pensionit, tatimet, konsultë ligjore, shërbime patronati (mbrojtjeje), etj.

Qendrat për punësimin (C.P.I.)

C.P.I.-të janë qendra që ndihmojnë njerëzit **për të gjetur punë.**

C.P.I. i garanton të regjistruarve një intervistë orientimi e një ofertë punë ose trajnimi brenda një periudhe të caktuar kohore nga fillimi i papunësisë.




Për çdo informacion
**numër pa pagesë 800-818-
282**

Për çdo **aktivitet vetëpunësimi** janë të nevojshme:

1. Hapja e një kodi TVSH (Tatimi mbi Vlerën e Shtuar).
2. Regjistrimi tek REGJISTRI I SIPËRMARRJEVE tek Dhoma e Tregtisë.
3. Regjistrimi tek INPS për kontributet e asistencës dhe të sigurimeve shoqërore
4. Regjistrimi tek INAIL (sipas rasteve të parashikuara)
5. Ti komunikohet BASHKISË hapja e aktivitetit për taksën mbi mbledhjen e mbeturinave.

Sporteli tek Dhoma e Tregtisë:
Camera di Commercio Via Capitan
Bavastro, 116 - Roma
Sajti internet:
www.rm.camcom.it/



A photograph of a classroom where several students have their hands raised, indicating an interactive learning environment. The background is a chalkboard with some faint writing. The text is overlaid on a semi-transparent grey grid.

Moduli 8
SISTEMI I ARSIMOR, TRAJNIMI,
EDUKIMI PËR TË RRITURIT

Sistemi arsimor

Arsimi i detyrueshëm është nga 6 - 16 vjeç.

Në moshën 14 vjeçare, pas shkollës dytësore të shkallës 1 (korrisondon me 9 vjeçaren shqiptare), mund të merret pjesë në kurse Trajnimi Profesionale (3 vjeçare) të aktivizuara nga Krahinat, të cilët përfundojnë me kualifikimet profesionale, duke përmbushur marrjen e arsimit të detyruar.





Çerdhet bashkiake nga mosha 0 në 3 vjeç



Kopshtet për fëmijë të bashkisë, shtetërore, të barabartë nga mosha 3 deri në 5 vjeç.



Shkolla parësore nga mosha 6 deri në 10 vjeç : 5 klasë



Shkollë dytësore e shkallës 1°
nga 11 deri 14 vjeç 3 klasë
Përfundon me një provim shtetëror.



Shkollë dytësore e shkallës 2° nga 14 deri 18 vjeç 5 klasë.

Përfundon me një provim shtetëror.


Kuriozitete

Kopshtet për fëmijë quhen zakonisht: "materne".

Shkollat parësore: "elementari".

Shkolla dytësore e shkallës 1° : "scuola media".

Shkollë dytësore e shkallës 2° : "scuola superiore".



Shkolla dytësore e shkallës 2° është e përbërë nga Shkollat e mesme, shkolla teknike e shkolla profesionale.

- Shkollat e mesme lëshojnë diploma të vlefshme për pranimin në Universitet.
- Shkollat *teknike për pranimin në Universitet* dhe në fushën e punës.
- Shkollat profesionale mund të lëshojnë:
 - a) pas 3 vitesh, kualifikime profesionale që janë të dobishme për futjen në punë.
 - b) pas 5 vitesh, diploma të vlefshme për pranimin në Universitet dhe në punë.



Arsimimi Teknik i Lartë(ITS)

Është arsimimi pas shkollës së mesme për formimin e figurave profesionale të specializuara, të njohura sipas kualifikimit EQF(Kuadri European i Kualifikimeve)



- Kurset zgjasin 2 vite dhe janë të ndarë në 4 semestra, gjithsej rreth 2000 orë.
- Pranimi bëhet përmes një shpallje konkursi
- Qëndrat ITS janë të drejtuara nga Fondacione që kanë një Institut Teknik referimi.

CTP – Qëndrat Territoriale të Përherhme

Janë në krye të edukimit që i drejtohet popullsisë të rritur, italiane e të huaj, për marrjen e shkollës dhe të aftësive të nevojshme në përfshirjen shoqërore dhe asaj të punës.

CTP-të, të përhapura në territor tek strukturat shkollore, janë të hapura edhe për emigrantët e moshës madhore, burra e gra, të punësuar apo të papunë, me kërkesa në përfshirjen dhe plotësimin nëpërmjet mësimit të gjuhës italiane.

tek CTP zhvillohen:

- Mësimet e Edukatës Qytetare
- Testi L2
- Kurset falas të Gjuhës Italiane A1 A2 B1 B2 C1 C2 me provimin e mundshëm të Çertifikatës

Dëftesa A2 e lëshuar me firmën e një Drejtuesi të CTP-së bën të mundur përjashtimin nga dhënia e Testit.





Universiteti

Ai përbëhet nga tre cikle:

1. Diplomë: zgjat 3 vite

2. Diplomë Master: 2 vjet

3. Kurse Doktorature, kurse Specializimi, kurse Master Universitar të nivelit 2° .



A photograph of a male doctor in a white lab coat and glasses, wearing a stethoscope, examining a female patient lying in a hospital bed. The doctor is leaning over the patient, and the scene is set in a brightly lit hospital room with a window in the background. The text 'Moduli 9' and 'SISTEMI SHËNDETËSOR' is overlaid on the image.

Moduli 9
SISTEMI SHËNDETËSOR

Shërbimi Shëndetësor Kombëtar(SSN)


Të gjithë shtetasit duhet të regjistrohen në SSN.

Regjistrimi u jep të drejtën për të

- zgjedhur mjekut e familjes
- bërë vizita ambulatorore
- marrë ilaçe me recetë
- bërë vizita të specializuara

Shembuj: vizita dentare, gjinekologjike, për sy, pediatrike, etj.

- bërë analiza diagnostike
- bërë shërbime spitalore



Shtetasit e huaj mund të regjistrohen tek S.S.N:

- nëse kanë një leje qëndrimi dhe kryejnë punë të rregullt ose ata të cilët janë të regjistruar si të papunë
- nëse janë të huajt me leje qëndrimi ose në procesin e rinovimit të lejes së qëndrimit ose azil kërkuar.



Për regjistrim nevojitet:

- Leja e qëndrimit ose marrja e kërkesës për ripërtëritje.
- vetëcertifikim i vendbanimit apo banim real.
- vetëdeklarim i numrit të kodit tatimor(C.F)

Edhe të huajt me hyrje dhe qëndrim JO TË RREGULLT në territorin italian kanë të drejtën e shërbimeve shëndetësore.

Për të huaj e parregullt (edhe në qoftë se ata nuk kanë një dokument të vlefshëm) **ASL** lëshon një kartë **STP**: I huaj në qëndrim të përkohshëm.



Karta STP jep të drejtën për tu:

- kuruar në ambulancë si dhe kura spitalore urgjente ose thelbësore gjithashtu edhe kura të vazhdueshme të sëmundjes dhe lëndimit.
- vaksinuar si mjekësi parandaluese (**vaksina**) me vëmendje të veçantë shëndetin e fëmijës.
- Gjithashtu jep të drejtën për të bërë mbrojtjen shoqërore të **shtatzënisë** dhe të amësisë.



Karta STP:

- mbron anonimitetin e të huajit
- është e vlefshme për 6 muaj (e ripërtëritshme)
- është e vlefshme në territorin kombëtar
- identifikohet me një kod



Lëshimi i STP nuk bashkëmbart sinjalizim tek Autoritetet.

Konsultori familjar

Konsultorët familjarë janë struktura shoqërore - shëndetësore, të lindur për t'iu përgjigjur nevojave të ndryshme të familjes, të gruas, të bashkëshortëve, të fëmijëve dhe të adoleshentëve.

Shërbimi është me karakter preventiv dhe është plotësisht **falas**.



Shërbimet e ofruara në konsultore janë:

- informacione dhe këshilla për lindje të përgjegjshme
- caktimin e ilaçeve kontraceptivë dhe aplikimin e kontraceptivëve mekanikë.
- këshillim psikoseksual
- Informacion për parandalimin e rreziqeve gjenetike dhe për kontrollin e shtatzënisë në rrezik dështimi.

consultorio
consultorio
familiare
familiare

- informacione mbi shterpësinë e çiftit
- procedurat për ndërprerjen e vullnetshme të shtatzënisë (I.V.G) edhe për të miturat, gjithashtu ndihmë mjekësore dhe psiko-sociale.
- parandalimin e kancereve të pjesëve gjenitale femërore

Shembuj: vizita, Pap testi, ekzaminimin e gjirit dhe teknikën e vetë-ekzaminimit

- kontrollin e shtatzënisë dhe kurse përgatitore mbi lindjen



Ndihma e shpejtë

118

Është numri që thirret nga numri fiks po ashtu edhe nga celulari në raste urgjente të rënda shëndetësore.

Për pak minuta vjen një Ambulancë

Mund të hyhet tek **URGJENCA** në mënyrë të pavarur, duke shkuar në njësitë spitalore të angazhuara në raste urgjente.



Me të mbërritur në spital, është caktuar një kod ngjyrash sipas **RËNDËSISË** të gjendjes shëndetësore për hyrjen në dhomën e vizitës dhe ndërhyrjen e parë.

- **KODI I KUQ:** urgjencë me hyrje të menjëhershme në dhomën e vizitave
- **KODI I VERDHË:** (urgjente) hyrje në dhomën e vizitave brenda 10-15 minuta
- **KODI I GJELBËRT:** (urgjencë që mund të shtyhet) nuk është në rrezik për jetën.
- **KODI I BARDHË:** jo urgjente

UNIONE EUROPEA
REPUBBLICA ITALIANA

Moduli 10

DOKUMENTE TË VLEFSHME

PASSAPORTO



Dokumente të vlefshme

Dokumentet e vlefshme më të rëndësishme në territorin italian janë: :

- *Letërnjoftimi (C.I.)*
- Kodi Tatimor (C.F.)
- Patentë shoferi (PAT.)

Ka edhe dokumente të tjera të rëndësishme si Karta shëndetësore dhe Pasaporta.



Letërnjoftimi

Letërnjoftimi është dokument personal identifikimi.

Përmban të dhënat e gjendjes civile, statusin civil, nënshtetësinë, profesionin dhe të dhëna të tjera personale..

Dokumenti duhet të ripërtërihet çdo 10 vjet dhe nuk është i vlefshëm për të udhëtuar jashtë vendit.



I huaji që banon rregullisht në Itali mund të kërkojë Letërnjoftimin.

C.I.(Letërnjoftimi) kërkohet në zyrën e Gjendjes civile të vendqëndrimit. Nevojiten 3 fotografi, dokument identifikimi dhe Lejeqëndrimi i paskaduar. Ose autorizimi nga ambasada(nullaosta) dhe kuitanca (ricevuta) për kërkesën e parë e lëshuar nga Kuestura.



Kodi Tatimor

Kodi tatimor është një kartë që nevojitet për të identifikuar në mënyrë unike qytetarët për qëllime tatimore dhe administrative.



Kodi tatimor kërkohet tek zyrat e Shërbimit të Ardhurave. Nevojitet Leje qëndrimi dhe një fotokopje e Pasaportës.

Patenta e shoferit

Patenta është një dokument që nevojitet për të udhëhequr automjetet me motor në rrugë publike.

Ky dokument lëshohet pas një provimi teorik-praktik.



Provimi për të marrë patentën përbëhet nga dy pjesë:

- një provë teorike mbi rregullat e rrugës, sjellja korrekte që duhet të mbahet, dhe kështu me radhë
- Një provë praktike udhëheqje makineje.

Prova teorike përbëhet nga një provë prej 40 pyetjesh me pyetje njëzgjedhore(e vërtetë apo e rreme).

Duhet tu jepet përgjigje e saktë të paktën 36 pyetjeve (jo më shumë se 4 gabime).




Kërkesa për të marrë Patentë shoferi dorëzohet në Zyrën e Motorizimit.

Nevojiten:

- 2 foto të kohëve të fundit format pasaportë, njëra prej të cilave legalizohet;
- Çertifikatë mjekësore me pullë takse (dhe fotokopje), me fotografi. Data e çertifikatës nuk duhet të jetë më e hershme se tre muaj, e lëshuar nga një mjek i licensuar.
- Dëshmi pagese të 24,00 € tek Llogaria Rjedhëse c / c 9001 dhe të 14,62 € tek Llogaria Rjedhëse c / c 4028

Nënshtetasit jo anëtarë të BE-së, duhet të bashkangjisin një leje qëndrimi ose kuitancën (ricevuta) e këkesës së ripërtëritjes ose lëshimin e lejeqëndrimit të parë. (për shqyrtim).

Moduli 11 BANESA



Qiraja e pasurisë së paluajtshme/1

Banesa

Për qiranë e një banese, ka dy forma të mundshme kontrate : qira me çmim të papërcaktuar dhe qira me rënien dakord të çmimit.



QIRA ME ÇMIM TË PAPËRCAKTUAR: Çmimi përcaktohet lirisht në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit. Kohëzgjatja minimale është fiksuar në katër vite dhe përtërihet automatikisht për 4 vite të mëtejshëm, me përjashtim të rasteve të veçanta (shërben si banesë për pronarin, shitja e apartamentit)

Qiraja e pasurisë së paluajtshme/2

QIRA ME RËNIEN DAKORT Të ÇMIMIT: Çmimi i qirasë mujore është përcaktuar në territor sipas marrëveshjes ndërmjet organizatave të qiramarrësve dhe atyre të pronarëve të banesave.

Për të dyja palët ka ulje taksash tatimore.

Kohëzgjatja është 3 vite dhe përtërihet automatikisht për dy të mëtejshëm, me përjashtim të rasteve të tilla si qira me çmim të papërcaktuar.

Kontratat regjistrohen në Zyrën e të Ardhurave brenda 30 ditëve nga nënshkrimi. Taksa 2% e qirasë të pëgjithshme vjetore ndahet ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit. Pagesa bëhet tek bankat apo zyrat e postës në një formular të quajtur F23.

AGENZIA DELLE ENTRATE

1. VERBALENTO DIRETTO AL CONCESSIONARIO DI PERUGIA

2. DEBITA (SERVICIUM A POSTE ITALIANE)

AGENZIA FISCALE PONTE S. GIOVANNI TRONTO PG

3. NUMERO DI RIFERIMENTO (1, 4, 6, 5, 9, 4, 7, B, X, 6, 5, 9, 0, 2, 2, 4, 5)

DATI ANAGRAFICI

4. COGNOME, ONOMAZIONE O NOME DI COGNOME: SAVASTANO LUIGI (0, 4, 0, 6, 1, 9, 6, 8)

5. COGNOME, ONOMAZIONE O NOME DI COGNOME: MICHELE VERDE (0, 5, 0, 1, 1, 9, 7, 5)

DATI DEL VERBALENTO

6. UFFICIO DI ENTE: 8, 7, 3, 2, 2

7. COD. TERRITORIALE (V.L. CONTENIDORO): T, E, R, 4

8. CAUSALE: 2

9. SISTEMI DELL'UNTO O DEL DOCUMENTO: R, P

10. IMPORTO: 2, 0, 1, 1, 1, 5, 3, 1, 4, 5, 1, 2

11. CODICE TRIBUTARIO

12. DESCRIZIONE (1)

13. IMPORTO

14. COD. DESTINATARIO

Blerja e pasurisë së paluajtshme

- Blerësi bën një ofertë blerjeje shitësit duke ofruar paraprakisht një shumë parash(depozita).
- Nëse propozimi pranohet nënshkruhet një Kontratë paraprake (premtim shitjeje) dhe blerësi do të paguajë depozitën.
- Akti i vërtetë i shitblerjes nënshkruhet përpara një Noteri (subjekti publik që garanton vlefshmërinë e kontratave të shitjeve); ky dokument quhet "Akt noterial". Blerësi derdh në konto shumën e përcaktuar në Kontratën paraprake.
- Blerja e shtëpisë mbart në vetvete pagesën e taksave tatimore.



Moduli 12

SISTEMI I SIGURIMEVE SHOQËRORE

OMIA
PENSIO
ALLA SEP

Sistemi i sigurimeve shoqërore

Sistemi i pensioneve transferon pasuritë në favor të atij që:

- ka ndaluar punën për shkak të moshës së pleqërisë : pensione pleqërie
- ka ndaluar punën për shkak se ka përmbushur moshën e vjetërsisë në punë: pensione vjetërsie pune



- nuk është më në gjendje të punojë për paaftësi: pensionet e aftësisë së kufizuar
- është i lidhur nga marrëdhënie familjare me personat e vdekur të cilët kanë qenë pjesë e krahut të punës: pensionet e të mbijetuarve
- nuk ka të ardhura dhe nuk është në gjendje të punojë: pensionet e asistencës

Sistemi financohet nga kontributet shoqërore të paguara nga punonjësit dhe punëdhënësit atyre enteve të cilët ofrojnë pensione.

Fondet janë të menaxhuara nga I. N.P.S. (Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore) dhe ente të tjerë për grupe të caktuara profesionale.

Për **pension pleqërie** nevojitet:

- Të kesh paguar të paktën 20 vite kontribute.
- Të kesh mbushur më 1 janar 2018 të paktën moshën 66 vjeç e 3 muaj (për burra e gra); e njëjta gjë edhe për të vetëpunësuarit.



Për **pension vjetërsie pune** nevojitet:

- Të kesh filluar pagesën e kontributeve para 31/12/1995
- Të kesh maturuar 41 vite e gjashtë muaj kontribute për gratë dhe 42 vite e gjashtë muaj për burrat.

Pagesat janë të barabarta me 33% të pagës bruto; 1/3 e këtyre janë në ngarkim të punëtorit, 2/3 paguhen nga punëdhënësi.



I.N.A.I.L.

I.N.A.I.L -i është një ent i sigurimeve shoqërore: *Instituti Kombëtar ndaj aksidenteve në punë.*

Mbron viktimat e aksidenteve në vendin e punës nga pikëpamja siguruese.



Sigurimi është i detyrueshëm dhe shumat janë të shumëllojshme sipas sektorëve: industri, artizanat, shërbime, ose aktivitete të tjera.

Shpenzimet për sigurimin përballohen tërësisht nga punëdhënësi.

Përveç në rastin e punës "paravartëse" (bashkëpunim me projekt), në të cilën punëtorit i takon derdhja e 1/3 të shumës.



Moduli 13

SISTEMI TATIMOR



Sistemi tatimor

Shteti dhe entet vendore (Krahinat, Provincat, Bashkitë) mund të vënë në dispozicion të qytetarëve shërbimet publike që nevojiten nëpërmjet DETYRIMEVE që të gjithë duhet ti paguajnë.

Taksat: derdhen vetëm nëse bëhet një veprimtari e caktuar

Shembuj: armëmbajtja, leje gjyetije, zënia e vendit publik



Taksat tatimore: përbëhen nga një marrje pasurie mbi tatimpaguesin, marrje jo e lidhur me një shërbim të Shtetit për ato shërbime që ai jep.

- *Tatime të drejtpërdrejta : në raport me pasurinë e gjithsecilit.*

Shembuj: IRPEF mbi të ardhurat e personave fizikë, IRES mbi të ardhurat e shoqërive, IMU mbi pasurinë e paluajtshme dhe plehrat, etj.

- *Tatime të tërthorta:* aplikohen kur ka një kalim pasurie

Shembuj : TVSH, Taksë Regjistri, Pullë takse, ecc.




Tatime të detyrueshme për ushtrimin e shërbimeve publike:

- *Tatime ndihme*: për mbulimin e rrezikimeve të lidhur me invaliditetin ose aksidenteve në punë

Shembuj : INPS, INAIL

- *Tatime të sigurimeve shtetërore*: për të marrë shërbime pensioni

Shembuj : INPS, INPDAP



Deklarimi i të ardhurave është dokumenti nëpërmjet të cilit shtetasi njofton Zyrën e TATIMEVE sa ka fituar dhe si rrjedhojë bën derdhen e shumës të TAKSAVE TATIMORE.

Deklarimi bëhet duke mbushur formularin **Modello 730** edhe i dorëzohet brenda datës 2 maj Punëdhënësit tënd ose tek një zyrë CAF (Qendra e asistencës Tatimore)



Brenda datës 15 mars të çdo viti punëdhënësi i dorëzon punëmarrësit **CUD**-in (Çertifikatë e vetme e punëmarrësit) me përmbledhjen e të gjitha të ardhurave të paguara vitin e mëparshëm.


CUD-i i bashkëngjitet formularit Modello 730. Tek formulari kallëzohen edhe të gjitha të ardhurat e tjera të përfuara (pasuri e paluajtshme, shërbime të ndryshme, rentë ecc.)

Përrjashtohet nga mbushja e formularit Modello 730:

- Kush përfton VETËM të ardhura nga punësimi në vartësi ose pensionistët
- Invaliditeti, pensionet e luftës etj.



SHËRBIME/ TARIFA



Shërbimet thelbësore janë të furnizuara nga Ente të shumllojshme, nëpërmjet lidhjes së KONTRATAVE TË FURNIZIMIT, që aktivizohen nëpërmjet thirrjes telefonike ose duke shkuar tek sportelet e qytetit.

Në kontratën e furnizimit janë të saktësuara menyrat e pagesës.

Çmimi që duhet paguar për pagimin e shërbimeve quhet TARIFË . Çmimi është i caktuar nga njëra anë nga Entet/Autorità qendrore dhe nga ana tjetër nga Shoqëritë që drejtojnë shërbimin.



Mbi Mbeturinat e Ngurta të Qytetit përkundrazi paguhet një TAKSË, që është e detyrueshme si rrjedhojë e zënies të çfarëdo lloj pasurie të paluajtshme.

Drejtimi e tërheqja e parave i është ngarkuar Bashkive.

Pagesa bëhet normalisht përmes formularit të Llogarisë Rrjedhëse të Postës, që dërgohet periodikisht.

Bëhet derdhja tek zyrat e Postës dhe disa Banka.



Moduli 14
MARRËVESHJA E INTEGRIMIT
DHE KARTA E QËNDRIMIT

Marrëveshja e Integrimit

Emigrantët që hyjnë në Itali për herë të parë duhet të nënshkruajnë Marrëveshjen e Integrimit

Është një sistem pikësh, që jepen me realizimin e disa veprimeve:

Shembull:

- | | | |
|----------------------------|------|----|
| - Zgjedhja e mjekut bazë | pikë | 4 |
| - Kontratë qiraje | | 6 |
| - Edukata qytetare | | 15 |
| - Gjuha italiane niveli A2 | | 24 |



Janë të parashikuara shkurtim pikësh në rast dënimesh edhe pse jo përfundimtare, në rast heqje lirie e gjobitje.

Marrëveshja e Integritit /2

**Në momentin e kërkesës të hyrjes
jepen 16 kredite**

**Brenda 2 vitesh i huaji duhet të
vërtetojë që ka arritur 30 kredite, të
plotësuara nga njohja e gjuhës
italiane të nivelit A2 dhe kuptimi i
vlerave kushtetuese dhe etike italiane**

**Nëse në 2 vitet e caktuara 30 kreditet
nuk arrihen, i huaji që ka më shumë
se zero kredite merr zgjatje afati për
një vit tjetër**



Marrëveshja e Integrimit /3

Gjatë vitit që i është shtyrë i huaji duhet detyrimisht të arrijë 30 kreditet. Por kursi i edukatës qytetare dhe njohja e italishtes të nivelit A2 janë të detyrueshme.

Mospjesmarrja në kursin e edukatës qytetare sjell shkurtimin e 15 krediteve

Mosarritja e 30 krediteve në vitin e 3^o sjell mospërtëritjen e lejeqëndrimit dhe përzënien nga territori



Marrëveshja e Integritit /4

Për të ruajtur 15 ndër 16 pikët e fillimit është e mjaftueshme të merret pjesë në kursin e edukatës qytetare të caktuar nga Prefektura

Për të arrirë 24 pikët përkatëse mbi njohurinë e gjuhës italiane të nivelit A2, është e mjaftueshme të regjistrohesh në një kurs falas tek Qëndrat e Përherhme në Territor (CTP) ose – gjithmonë falas – tek shkollat vullnetare që kanë marrëveshje me CTP-it. Kur përfundohet kursi lëshohet dëshmi e vlefshme vetëm për të marrë Lejeqëndrimin.

Tashmë këta 2 elementë bëjnë të mundur kalimin e 30 pikëve dhe të kushteve të kërkuara



Është mundësia të bëhet një PROVIM – me pagesë – për të marrë një ÇERTIFIKATË, e vlefshme edhe për Lejeqëndrim po edhe për veprimtari të tjera ose regjistrim për Kurse formimi.

Karta e qëndrimit afatgjatë

I huaji i pranishëm rregullisht në Itali prej më shumë se 5 vitesh, me të ardhura vjetore të barabarta me çekun social (5143 Euro) dhe që nuk ka çështje gjyqësore të pa përfunduara, mund të kërkojnë KARTËN E

QËNDRIMIT :

- për vetveten
- për bashkëshorten me moshë më shumë se 18 vjeç
- për fëmijët e mitur në ngarkim
- për prindërit në ngarkim

Por duhet të vërtetohet që ka marrë dëshminë e njohurisë të italishtes të paktën për nivelin A2, që mund ta marrë me të njëjtën mënyrë të marrëveshjes së integritimit

Kërkesa paraqitet duke mbushur formularin përkatës tek Zyrat e Postës

Karta e qëndrimit afatgjatë / 3

Për njohurinë e gjuhës italiane, i huaji mund edhe të bëjë direkt kërkesë Prefekturës për t'iu nënshtruar një testimi falas në sajtin internet:

<http://testitaliano.interno.it>

Do të thirret për provimin brenda 60 ditëve nga këkesa



Nuk duhet të vërtetojë njohurinë e italishtes: 1) kush ka marrë titull studimor ose profesional në Itali; 2) kush ka hyrë në territor me procedurën "kualifikime të larta"; 3) kush, me çertifikatë nga strukturat shëndetësore publike, ka aftësi të kufizuar të të mësuarit (sipas moshës, patologjive, handicap)

Bashkimi familjar

Shtetasi i huaj, që ka një lejeqëndrim: punësimi në vartësi, vetëpunësimi, për studime, me një kohëzgjatje jo më pak se një vit, gjithashtu edhe huaji me Kartë qëndrimi afatgjatë, mund të kërkojë që të bashkohet me njerëzit më të afërt në mënyrë që të mbajë familjen e bashkuar.

Mund të bëhet kërkesë për:

- bashkëshortin/-en;
- Fëmijët e mitur, edhe të bashkëshortit/-es ose të lindur jashtë martesë, kur prindërit ishin jo të martuar ose të ndarë me ligj (në këtë rast bashkimi bëhet me miratimin e prindit)
- fëmijët e rritur në ngarkim ku ata nuk mund të vetëmbahen për shkak të gjendjes shëndetësore
- Prindërit në ngarkim që nuk kanë një mbështetje familjare në Vendlind nga vijnë.



Bashkimi familjar / 2

Procedura

• Mbushet një formular përkatës kërkesë dhe dorëzohet tek Sporteli Unik së bashku me fotokopjen e Pasaportës, të Lejeqëndrimit, dhe të një dokumenti përkatës mbi banesën dhe të ardhurat e përftuara.



• Ndërsa i afërmi i kërkuarit duhet ti paraqesë Konsullatës italiane në vendin ku ai jeton, dokumentat përkatës që tregojnë raportin e farefisnisë, ose moshën e mitur, ose gjendjen shëndetësore.



• Sporteli Unik lëshon kuitancë(dëftesë) të kërkesës e të dokumentave të paraqitur. Brenda 90 ditëve nga marrja e kërkesës, Sporteli Unik lëshon Autorizimin (Nullaosta), ose mospranimin dhe e informon Konsullatën



Bashkimi familjar/ 3

Procedura

↓

- Pasi të kenë kaluar 90 ditë i afërmi mund ti dorëzojë Konsullatës italiane jashtë shtetit kopjen e kuitancës(dëftesës) të kërkesës me dokumentat e paraqitur tek Sporteli Unik për të marrë Vizën e hyrjes.

↓

- Brenda 8 ditësh nga hyrja i komunikohet Sportelit Unik mbërritja e të afërmit dhe pritet thirrja për tërheqjen e dokumentave të nevojshëm për kërkesën e lejeqëndrimit. Formularët e plotësuar i dërgohen Kuesturës nga një Zyrë e Postës. Zyra e Postës lëshon një kuitancë(dëftesë) me dy KODE personale (userid e password) në mënyrë që të kontrollohet nëpërmjet internetit gjendja e praktikës.

Lejeqëndrimi për shkaqe familjare lejon të zhvillohet punësim në vartësi ose vetëpunësim, të regjistrohesh në kurse shkollore, të pranohesh në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar.

Moduli 15

SHTETËSIA



Shtetësia

Merret:

1) Nëse banohet pandërprerje në Itali për 10 vite, nëse zotërohen burime jetese të përshtatshme dhe nëse nuk ka dënime të mëparshme. Marrja e shtetësisë nuk bëhet automatikisht por arrihet nëpërmjet një kërkesë.

2) Nëse një fëmijë lind në Itali nga prindër të huaj dhe banon pandërprerje deri në moshën 18 vjeç, duhet të bëjë kërkesën brenda moshës 19 vjeç.

3) për martesë me një shtetas italian, pas 2 vite vendbanimi të ligjshëm në Itali ose pas tre vite martese nëse vendbanohet jashtë territorit italian (afate të përgjysmuara në prani të fëmijëve të lindur ose të birësuar nga bashkëshortët), me kusht mungesën e dënimeve të mëparshme.





Kurs i edukatës qytetare: Për të qenë shtetas *italianë* Janar 2014

Autorë:



Shoqatat vullnetare e të shoqërisë private të mbështetura nga CESV-SPES

Via Liberiana, 17 00185 Roma Tel: 06491340
scuolemigranti@cesv.org www.scuolemigranti.it

Redaktimi nën kujdesin e : Francesca Abbate, Daniela Bossa, Valentina Casavola, Daniele Diviso, Fiorella Farinelli, Augusto Venanzetti

Projekti grafik: Francesca Abbate

Përkthimi nga italishtja u bë nga: Sonila Kçira

